UNIVERSITETI ALEKSANËR MOISIU DURRËS

FAKULTETI I BIZNESIT

DEPARTAMENTI I FINANCË -KONTABILITETIT

KONKURS MBI PUNËT KËRKIMORE JSTOR

FUSHA E APLIKIMIT: POLITIKË EKONOMIKE DHE DIPLOMACI

TEMA: CEFTA 2006 DHE RRUGËTIMI DREJT BE. PIKËPAMJET POLITIKE-EKONOMIKE.

Punoi: Anisa Sinanasi

Dega Financë -Kontabilitet, viti akademik 2021-2022

Durrës, 2021

HYRJE

Ballkani Perëndimor ka qënë gjithmonë në konflikte të vazhdueshme për cështje të cilat ende kanë mbetur të pazgjidhura. Nëpër lajmet që qarkullojnë ditët e sotme në emisone televizive është diskutuar së fundmi nisma Open-Balkan dhe për atë cfarë kjo nismë synon. Në kohën kur është bërë ky studim vetëm tri shtete janë bërë pjesë, ndër to edhe Shqipëria, dhe bëhet thirrje për pjesëmarrjen e shteteve të tjera, por situata nuk duket premtuese. Cfarë e solli Ballkanin Perëndimor në këtë situatë? Pse këto vende të rajonit janë konfliktuar dhe ende nuk po gjejnë zgjidhje? Në politikat e BE dhe SHBA është evidentuar vazhmisht domoshdoshmëria për bashkëpunim brenda rajonit dhe me anë të CEFTA 2006 u hodh hapi I parë drejt një bashkëpunimi rajonal. Në këtë punim do të shqyrtohet se cfarë është CEFTA dhe cfarë e bën këtë kaq të rëndësishme për Republikën e Shqipërisë dhe vendet e tjera të rajonit. Shqipëria duhet të shfrytëzojë maksimalisht mundësitë që i serviren dhe të krijojë mundësi të reja për të bërë një hap tjetër galopant sic është anëtarësimi në BE. Do të shohim si paraqitet situata për anëtarësim në BE dhe duke hedhur një vështrim mbi problemet ekonomike dhe politike të rajonit dhe të përcaktojmë se cilat janë cështjet më problematike që e pengojnë të bëjë progres.

Përmes shqyrtimit të literaturës nga autorë të ndryshëm dhe pasurimit me të dhëna statisikore dhe ekonomike do të mundësohet përcaktimi i pozicionit të shqipërisë në cështje të ndjeshme si ajo e BE-së.

Qëllimi kryesor I punimit konsiston në zgjerimin e informacionit në aktualitetin e Ballkanit dhe ndërgjegjësimin për problemet me të cilat ky rajon mund të perballet në rast se nuk veprohet në kohën e duhur. Duke u larguar nga informacione të njëanshme dhe nga burime jo të sigurta, ky studim kërkon të paraqesë tablonë e përgjithshme të progresit ose të regresit në nivel rajoni.

Fjalët kyce ; *CEFTA 2006, anëtarësim në BE, probleme rajoni, kritere, zgjidhje*

ZHVILLIMI

CEFTA ose Central European Free Trade Agreement është një marrëveshje e nënshkruar mes vendeve të Europës Qëndrore në vitin 1992 me qëllim tregtinë e lirë midis tyre. Pas anëtarësimit të shteteve të EQ me BE u nënshkrua marrëveshja CEFTA 2006 mes vendeve të Ballkanit Perëndimor, përkatësisht Shqipërinë, Bosnjë-Hercegovinën, Maqedoninë e Veriut, Serbinë, Malin e Zi, Kosovën dhe Moldavinë. Kjo marrëveshje u nënshkrua në vitin 2006 dhe filloi të zbatohej në vitin 2007. Me anë të saj do të bëhej I mundur testimi se sa këto shtete pjesëmarrëse mund të bashkëpunonin mes tyre në mënyrë që të bëheshin konkurente në treg dhe të mos rrisnin më tej varësinë ndaj tregut të BE (M. Petreski 2013). Sipas (Sergi & Qerimi, 2007) CEFTA e re dhe Marrëveshja e Stabilizim Asociimit do të bëjnë të mundur reduktimin e mëtejshëm të pengesave tregtare dhe investuese dhe hapjen e tregut për rritje dhe konkurencë.

Në studimin e kryer mbi procesin e zgjerimit të BE-së duke pasur fokus kryesor Ballkanin Perëndimor, vihet re në dukje një ngjajshmëri në ecurinë e zhvillimit të vendeve të BP dhe isht-anëtarëve të CEFTA, tashmë anëtarë të BE (Mitrović & Bjelić, 2015). Kjo në dukje jep idenë që vendet e BP janë duke ecur në një rrugë të shkelur më parë dhe zhvillimi I mëtejshëm mund të arrihet duke ecur në po të njëjtat hapa. Kjo ide bie posht për faktin se me nënshkrimin e MSA-së u hartuan pika të reja për kushtet e pranimit të vendeve të reja në BE, kushte të cilat janë më tepër të orientuara drejt politikës. Anëtarësimi në BE mbetet një nga cështjet më sensibël të Shqipërisë dhe përbën një nga sfidat e së ardhmes.

CEFTA 2006 dha një kontribut të rëndësishëm për progresin e përmbushjes së një prej kritereve të vendosura nga BE, sic është kriteri ekonomik. Megjithatë, nevoja për përmirësim është evidente. Ngritja e institucineve që garantojnë demokracinë, shtetin ligjor, respektimin e të drejtave dhe lirive të individit, respektimi dhe mbrojtja e minoriteteve, kriteri ekonomik që përcakton ekzistencën dhe funksionimin e ekonomisë së tregut, mundësinë për të përballuar presionin konkurues dhe forcat e tregut brenda BE dhe aftësinë për të përmbushur detyrimet që rrjedhin nga anëtarësimi përbëjnë kushtet themelore të anëtarësimit në BE (Banka e Shqipërisë, 2021).

Zona e Ballkanit Perëndimor ka qënë gjithmonë një pikë ku ka pasur konflikte të vazhdueshme të cilat kanë penguar zhvillimin e mëtejshem dhe progresin që mund të arrihej me sheshimin e këtyre mosmarrëveshjeve. Ky rajon cilësohet si I destabilizuar dhe kjo për një sërë arsyesh. Prespektiva dhe dëshira e madhe për tu bërë pjesë e familjes së BE është e rrezikuar nga vonesat dhe pritjet e gjata me të cilat kandidatët ose aspirantët për të kandiduar duhet të përballen. Kësaj I shtohen edhe kriteret e shumta dhe të largëta në këndvështrimin e tyre (Bugajski, 2013).

Nisur nga studimi I fundit I publikuar mbi kohëzgjatjen në vite në të cilën priten të anëtarësohen në BE shtetet e Ballkanit Perëndimor rezulton se më e largëta në këtë rrugëtim është Bosnjë-Hercegovina me 68 vite ndërsa vendi I cili pritet të anëtarësohet I pari është Mali I Zi me 38 vite. Për sa I përket Shqipërisë, rezultatet nuk janë të kënaqeshme për faktin se është 48 vite larg anëtarësimit. Sipas arsyetimit logjik, tri vendet që kërkojnë më shumë kohë, janë tepër të rrezikuar për tu kapluar nga pesimizmi dhe për të kërkuar një tjetër rrugë dalje nga destabilizimi (European Policy Institute of Kosovo, 2021).



	TOTALI	SHQIPERIA	BOSNJE-HERCEGOVINA	KOSOVA	MAQEDONIA E VERIUT	MALI I ZI	SERBIA
NUK E DI	4	1	4	3	2	7	6
NEGATIVE	11	2	12	3	11	15	24
AS POZITIVE, AS NEGATIVE	26	10	28	19	30	24	44
POZITIVE	59	87	56	75	57	54	26

Figura nr. 1

Kjo na bënë të kthejmë sytë drejt një konkurenti të konsiderueshem të BE dhe SHBA, drejt Rusisë. Në rast se vendet e rajonit distancohen nga marrëdheniet diplomatike me perëndimin, atëherë përfitimi I Rusisë në këtë situatë do të jetë I madh. Rusia ka penguar suksesin pothuajse ne çdo hap që shtetet e Ballkanit Perëndimor kanë marrë për tu afruar me NATO-n apo BE-në. (Secrieru, 2019). Shtetet ballkanike që kanë mbetur pa u anëtarësuar në BE pranojnë se nuk ka gjasa të anëtarësohen në Bashkimin Evropian në të ardhmen e afërt. Sipas studimit të mësiperm kjo tezë mbështetet dhe bëhet më bindëse. Sipas autorëve (Jeffrey& Andrey, 2020), konkurenti tjetër, Kina, është tepër e distancuar gjeografikisht, por përvec kësaj, ajo nuk ka shprehur interes për këtë rajon për shkak të acarimeve dhe konfliketeve të thella të rajonit. Kjo tezë mund të kundërshtohet me të drejtë. Kina është bërë tashmë një fuqi me qëllime afatgjata në Ballkan. Kjo vlerësohet si e tillë për shkak se bashkëpunimi me Malin e zi daton që në 2010 në sajë të Partisë malazeze Demokratike të Socialistëve dhe Partisë Komunise të Kinës. Nga ana tjetër partneriteti strategjik me Serbinë ka përfunduar në 2009. Kosova nuk mbetet jashtë planeve të Kinës. "[Kina gjithashtu ka tentuar të rrisë praninë e saj në Kosovë duke bërë ofertë - pa sukses - për të ndërtuar njëtermocentrali me qymyr atje dhe për t'i shitur pajisjet Huawei kompanisë kryesore të telekomit në Kosovë] " (Shopov, 2021).

Duke analizuar të dhënat e marra (Balkan Barometer,2020), mund të sjellim një rezultat të reagimeve të rezidentëve të BP kur u përmendet anëtarësimi në BE. Nga përgjigjet shohim që vetëm 26% e të anketuarve në Serbi janë përgjigjur pozitivisht. Këtu mund të vlerësojmë Serbinë si një shtet që mund të ketë prirje për distancim nga BE në sajë të pritshmërive të ulta që paraqiten nga përgjigjet negative me 24% që është edhe më e larta në rajon. Vendet më afër unionit janë Shqipëria me 85%, e pasuar nga Kosova me 75%. Vendet e tjera janë në përgjigje pozitive mbi 50% dhe përgjigje negative relativisht të ulta.

BE, krahas fuqisë së saj që i atribuohet diplomacisë dhe bashkëveprimit mes shteteve, ka edhe pikën e saj të dobët. Kohët e fundit ndjehet një krizë politike dhe ekonomike brenda unionit. Greqia, Italia dhe Spanja janë futur në borxhe të thella dhe kjo është bërë shkak për një pasiguri ekonomike. Anëtarë të tjerë që janë bashkuar së fundmi si Rumania dhe Bullgaria kanë performuar me tregues që lënë për të dëshiruar (Lovelace, 2013).

Duke lënë pas dobësitë e BE, do të hedhim vështrimin drejt deficencave të rajonit. Shohim në mes një krizë politike dhe ekonomike. Chayes thotë:"[Shkëlqimi i jashtëm i qeverive me pushtetarë të korruptuar mund të kamuflojë se sa të thyeshme janë në të vërtetë. Ata që duan të lidhin aleanca me të tilla qeveri për të krijuar stabilitet, duhet të kenë kujdes]" (2016). Ajo definon rrezikun që vjen nga aleancat strategjike të në nenshkruara me vende me korrupsion, të kamufluar ose jo. Korrupsioni është një nga plagët e BP dhe duke u pasuar nga reformat e pakta në drejtësi, përbëjnë një ambient të posacëm për zhvillimin e krimit të organizuar, për brengosjen nga padrejtësitë, dhe si rrjedhojë për një dëshirë për tu larguar sa më parë nga faktorët demoralizues. Shqipëria ka ndërmarrë një nismë, nga më të rëndesishmet, atë të vettingut të gjyqtarëve dhe prokurorëve ose sic njihet ndryshe reforma në drejtësi. Ky proces përqëndrohet në tri komponentë që janë pasuria, figura ose lidhja me krimin e organizaur dhe aftësia profesionale. Kjo reformë daton më 22 korrik të 2016 (Skëndaj, 2019). Pervecse në demokracinë e dobët, korrupsioni ndikon edhe në humbjen e besimit te liderët politikë. Dështim pas dështimi, nepotizmi dhe të tjera të ngjajshme përbëjnë shkaqe për destabilizim politik, ekonomik dhe shoqëror. Këtyre ngjarjeve I shtohet edhe nacionalizmi I tepruar cili shpesh herë është bërë shkaktar për moskonsolidim të marrëdhënieve brenda rajonit. Aty ku ndërtimi I shtetit shihet I paplotë dhe karakterizohet nga institucione qeveritare që nuk shihen si partnere totalisht legjitime, aty shohim praninë e nacionalizmit dhe të populizmit (Bugajski, 2013).

Një nga konfliktet më të nxehta dhe më problematike është cështja territoriale në rajon. Mund ta klasifikojmë faktorin si nga më penguesit dhe destabilizuesit, krahas cështjes së minoriteteve etnike për të cilën do të flasim më poshtë. Këtu kemi të bëjmë me mentalitetin e të gjithë Ballkanit I cili paraqitet si një zonë e minuar në të cilën minat mund të plasin në cdo kohë. Konfliktuesit e parë të marrë në shqyrtim janë Serbia dhe Kosova që shpesh herë janë bërë pjesë e mediave. Të mos lëmë këtu pa përmendur ngarjen e freskët të reciprocitetit të targave ku tensionet u përshkallëzuan dukshëm (Shehu, 2021). Megjithatë, duke hulumtuar për marrëdhëniet diplomatike dhe cështjen Kosovë -Serbi, jepet një zgjidhje e cila sic duket ka nisur. " [Serbia dhe Kosova kanë nisur një proces të shkëmbimit territorial që mund të ketë pasoja serioze, si në Ballkanin Perëndimor ashtu edhe ne arenen nderkombetare. Historikisht, shkëmbimet territoriale kanë një rekord të përzier. Në disa raste, këto projekte kanë inauguruar periudha të zgjatura bashkëpunimi dhe pajtimi. Megjithatë, në disa raste, marrëveshje të tilla kanë pasur pasoja shkatërruese dhe kanë çuar në masakër, dhunë dhe spastrim etnik. Ndërsa Serbia dhe Kosova kanë të drejtën sovrane dhe demokratike për t'u angazhuar në një dialog të vërtetë dhe për të vendosur për rregullimin e kufijve të tyre, është e rëndësishme që komuniteti ndërkombëtar t'i kushtojë vëmendje dinamikës së procesit dhe të marrë në konsideratë stabilitetin dhe sigurinë e rajoni më i gjerë duhet të realizohet ky projekt.] " (Zdravkovski, 2019).

Sipas analistëve të cështjes kuptojmë që këto shkëmbime mund të bëhen vetëm kur vendet e njohin pavarësinë e njëra-tjetrës. Me situatën ku Serbia ende nuk njeh pavarësinë e Kosovës mund të vlerësojmë se deri më tani këto ide janë të paimplementueshme. Rikujtojmë që shkak për shpërthimin e Luftës së Parë Botërore qenë pikërisht këto minoritete etnike në këtë zonë. Për më tepër, në rast se nuk gjendet një zgjidhje, nuk do të ketë traktat të mossulmeve që do të mund të ndalojë luftën në rast se situata agravon (Wolfe, 1934).

Cështja e pakicës së romëve në BP përbën një tjetër problem në aspektin e minoriteteve. Hendeku mes miratimit dhe implementimit të ligjeve për mbrojtjen e të drejtave të minoriteteve etnike është i madh. Pakica rome është rritur dukshëm vitet e fundit dhe përben një masë të madhe në rajon. Serbia është një nga vendet që duhet të jetë më rigoroze në hartimin dhe zbatimin e ligjeve që garantojnë të drejtat dhe liritë e minoriteteve etnike për shkak se ka shumë minoritete në përbërje të saj, dhe këto e bëjnë shoqërinë të rrezikuar nga grupet e krijuara me qëllim vetëmbrojtjen. Këto grupime bëhen shkak për konflikte agresive për shkak të radikalizimit të viktimave ose/dhe autorëve (Cierco, 2017).

Maqedonia e Veriut gjithashtu po përballet me tronditje të mëdha. Njëra prej tyre është skandali mbi përgjimet e aparatit shtetëror ku janë evidentuar struktura të korrupsionit nga partia drejtuese. Është faktuar plani për përmbysjen e zgjedhjeve nëpërmjet kontrollit të gjykatave dhe të shtypit. Në Kumanove pati gjithashtu një betejë mes policisë dhe shqiptarëve etnikë në atë zonë ku mbetën shumë të plagosur. Të nesërmen pasi beteja e armatosur përfundoi, u shkatërrua një tjetër qytet multietnik ku qytetarë dhe rezidentë mbetën të vrarë. Pakica shqipëtare në ato zona ndjehet e pasigurt me pabarazinë e theksuar. Këtu cënohet siguria rajonale dhe legjitimiteti i qeverisë. BE duhet të rrisetë presionin gjithëpërfshirës në mënyrë që situata të merret në dorë. Vendi rrezikon të shkojë në zgjedhje të parakohshme (International Crisis Group, 2015).

Ndërkohë SRPSKA kërkon të shkëputet institucionalisht nga Bosnjë-Hercegovina pasi boshnjakët u vendosën në të, në shtëpinë e tyre të vjetër, dhe Serbët në rezidencat e Federatës Boshnjake (Gearoid, 2006). Dodik kërkon të krijojë një ushtri të pavarur nga ajo e Bosnjë- Hercegovinës. Këto ngjarje kanë tërhequr vëmendjen e liderëve për stabilizimin e sigurisë sepse këto zhvillime kanë gjasa të sjellin edhe një shpërthim të një konflikti të mundshëm (Milo, 2021). Ky konflikt i mundshëm mund të zbutet për faktin se [...Dodik ka thënë se ai synon autonominë e plotë të Republikës Serbe brenda Bosnjës, në vend të shkëputjes, e cila nuk do të ndikojë në integritetin territorial të vendit.] (Daria, 2021).

Cështjet që kanë ngelur pezull dhe që kanë krijuar një barrierë për zhvillim të mëtejshëm është statusit final i kosovës dhe dorëzimi i të arratisurve më të kërkuar të Gjykatës Penale Ndërkombëtare për ish-Jugosllavinë Ratko Mladic dhe Radovan Karadzic (van Ham, 2014).

KRIZAT DHE MUNDËSITË PËR ZHVILLIM NË KËNDVËSHTRIMIN EKONOMIK

Krizat ekonomike karakterizohen nga tregues problematikë si papunësia, rënia ose qëndrimi në stajnacion i rritjes ekonomike, pakësimi i remitancave, deficiti buxhetor dhe borxhi i qeverisë. Në vitin 2020 borxhi publik i shqipërisë ka arritur vlerën prej 77.84%, vlera më e lartë në 10 vitet e fundit. Shiko figurën nr 3 (Buletini Statistikor i Borxhit, 2020). Nga ana tjetër papunësia është mbajtur në vlera relativisht të njëjta me vitin e kaluar (Tregu i Punës, 2020).

Një kontribut të rëndësishëm dha CEFTA e lartpërmendur në zhvillimin e bujshëm të tregtisë për vendet e rajonit në sajë të shkëmbimeve tregtare, të heqjes së barrierave doganore dhe lehtësimit administrativ. Megjithatë tregtia vazhdon të mbetet e ulët. Ky tregues nuk mund të justifikohet me mungesën e tregtisë së lirë apo me barrierat tarifore. Ato që lënë vend për interpretim janë barrierat jotarifore. Pengesat që nuk e lejojnë zhvillimin e mëtejshëm janë korrupsioni, procedurat e gjata dhe mungesa e vullnetit politik. Ajo që duhet bërë është implementimi i tarifave edhe më të ulta

dhe liberalizimin e tregtisë së shërbimeve krahas tregtisë së mallrave. Me këtë ndryshim do të rritej konkurenca dhe tregu do të vetëpërmirësohej. Sugjerohet përshtatja me sandardet europiane në procesin e tregtimit dhe tarifimit. Duke ditur që CEFTA nuk dha maksimunin e saj në lidhje me IHD, duhet të hartohet një plan në lidhje me tërheqjen e tyre. Duhet të ngrihen kapacitetet publike dhe private në mënyrë që të bëhet e mundur përfshirja e burimeve njerezore për zhvillimin e aftësive dhe njohurive, zhvillimin e infrastrukturës, tekonologjisë dhe ndërmarrjeve (Zeneli, 2014).

Duhet rritur tregtimi i produkteve bujqësore dhe ushqimore. Ashtu si me IHD-të, CEFTA nuk ka arritur të zhvillojë tregtimin e këtyre mallrave, përkundrazi, kjo marrëveshje përmban kufizime të shumta në këtë aspekt sepse u fokusua më së tepërmi në tregtimin e produkteve industriale. Lehtësimi për tregtimin e tyre do të shërbente për të rritur tregtinë e jashtme në vlera të konsiderueshme (Totev, 2001).

KONKLUZIONE DHE REKONMANDIME

Në përfundim të këtij punimi u krijua një panorame e përgjithshme mbi Ballkanin Perëndimor dhe situatën politike. Zhvillimet e fundit në rajon janë problematike, megjithatë shpresojmë që diplomatët të arrijnë në konsesus në mënyrë që të mos pengohet më progresi ekonomik dhe politik.

U njohëm me CEFTA-n dhe rëndësinë që ajo pati për rrugëtimin e gjatë të Ballkanit në fushën e bashkëpunimit rajonal.

Krizat e përgjithshme të rajonit janë të tilla si cështjet e minoriteteve, korrupsioni, nacionalizmi i tepruar. Më e theksuar mbetet edhe kriza ekonomike në lidhje me borxhin publik, papunësinë dhe deficitin buxhetor.

U prezantuam me konkurentët potencialë të BE dhe cilat janë prespektivat e së ardhmes për rajonin. Përmendim këtu Shqipërinë e cila i qëndron besnike politikave të BE.

Ashtu si cdo union, edhe BE ka momente krizash dhe këto u evidentuan në krizën ekonomike dhe distancimin e vendeve të Ballkanit nga BE.

Kriza ekonomike e Ballkanit nuk ka se si të mos prekë edhe Shqipërinë. Kjo tregohet në vlerën e lartë të borxhit publik i cili është më i larti në vitet e fundit, por kjo mund të jetë rezultat edhe i keqmenaxhimit të fondeve.

Për të zhvilluar ekonominë dhe marrëdhëniet mes vendeve duhet pasur parasysh që për të marrë dicka, duhet të japësh dicka tjetër ne kembim. Ne këtë kontekst shkëmbimi i territoreve në bazë të shumicave etnike do të ishte i pranueshëm, por jashtëzakonisht i kundërshtueshëm nga BE dhe ShBA.

Tregtia duhet të liberalizohet edhe më shumë dhe vendet duhet të dialogojnë.

1. Petreski, Marjan. “Southeastern European Trade Analysis: A Role for Endogenous CEFTA-2006?” *Emerging Markets Finance & Trade*, vol. 49, no. 5, Taylor & Francis, Ltd., 2013, pp. 26–44, http://www.jstor.org/stable/24475378.
2. Sergi, Bruno S., and Qerim Qerimi. “The Process of EU Enlargement towards South-Eastern Europe: Current Challenges and Perspectives.” SEER: Journal for Labour and Social Affairs in Eastern Europe, vol. 10, no. 2, Nomos Verlagsgesellschaft mbH, 2007, pp. 57–65, http://www.jstor.org/stable/43293211.
3. DRAGUTINOVIĆ-MITROVIĆ, Radmila, and Predrag BJELIĆ. “TRADE REGIMES AND BILATERAL TRADE IN THE EU ENLARGEMENT PROCESS: FOCUS ON THE WESTERN BALKANS.” Acta Oeconomica, vol. 65, no. 2, Akadémiai Kiadó, 2015, pp. 249–70, http://www.jstor.org/stable/24857637.
4. https://www.bankofalbania.org/Rreth_Bankes/Marredheniet_nderkombetare/Dhoma_e_Evropes/Bashkimi_Evropian/
5. Bugajski, Janusz. “WEST BALKAN CONFLICTS: CAUSES AND CONSEQUENCES.” *RETURN OF THE BALKANS: CHALLENGES TO EUROPEAN INTEGRATION AND U.S. DISENGAGEMENT*, Strategic Studies Institute, US Army War College, 2013, pp. 142–54, http://www.jstor.org/stable/resrep12063.12
6. https://www.epik-eu.com/publications
7. Secrieru, Stanislav. *RUSSIA IN THE WESTERN BALKANS: Tactical Wins, Strategic Setbacks*. European Union Institute for Security Studies (EUISS), 2019, http://www.jstor.org/stable/resrep21130.
8. Shopov, Vladimir. *DECADE OF PATIENCE: HOW CHINA BECAME A POWER IN THE WESTERN BALKANS*. European Council on Foreign Relations, 2021, http://www.jstor.org/stable/resrep29125.
9. Mankoff, Jeffrey, and Andrey Kortunov. *Addressing Unresolved Challenges in U.S.-Russia Relations*. Center for Strategic and International Studies (CSIS), 2020, http://www.jstor.org/stable/resrep24259.
10. LOVELACE, DOUGLAS C., and Janusz Bugajski. “FOREWORD.” RETURN OF THE BALKANS: CHALLENGES TO EUROPEAN INTEGRATION AND U.S. DISENGAGEMENT, Strategic Studies Institute, US Army War College, 2013, pp. ix–xii, http://www.jstor.org/stable/resrep12063.3.
11. Chayes, Sarah. *Corruption and State Fragility*. US Institute of Peace, 2016, http://www.jstor.org/stable/resrep12210.
12. http://avokatia.al/revista/19-avokatia-33/71-kushtetutshmeri-33
13. https://www.dw.com/sq/kosovë-serbi-tensione-dhe-bllokadë-rrugësh-në-veri-vazhdon-reciprociteti-i-targave/a-59245829
14. https://www.insightturkey.com/commentaries/the-proposed-territorial-exchange-between-serbia-and-kosovo
15. WOLFE, HENRY C. “The Balkan Minorities Problem—One Way Out.” *The American Scholar*, vol. 3, no. 4, The Phi Beta Kappa Society, 1934, pp. 437–43, http://www.jstor.org/stable/41204089.
16. Cierco, Teresa. “The Limits of Europeanization on Minority Rights in Serbia: The Roma Minority.” International Journal on Minority and Group Rights, vol. 24, no. 2, Brill, 2017, pp. 123–49, https://www.jstor.org/stable/26557870.
17. International Crisis Group. *Macedonia: Defusing the Bombs*. International Crisis Group, 2015, http://www.jstor.org/stable/resrep31823.
18. Gearóid Ó Tuathail (Gerard Toal), and Carl Dahlman. “The ‘West Bank of the Drina’: Land Allocation and Ethnic Engineering in Republika Srpska.” *Transactions of the Institute of British Geographers*, vol. 31, no. 3, [Royal Geographical Society (with the Institute of British Geographers), Wiley], 2006, pp. 304–22, http://www.jstor.org/stable/4639977.
19. https://www.reuters.com/world/ill-not-sacrifice-peace-republika-srpska-bosnian-serb-leader-says-2021-11-11/
20. van Ham, Peter. “Conclusions: The EU Must Acknowledge Its Limits.” Gridlock, Corruption and Crime in the Western Balkans: Why the EU Must Acknowledge Its Limits, Clingendael Institute, 2014, pp. 19–22, http://www.jstor.org/stable/resrep05414.6.
21. https://www.financa.gov.al/treguesit-e-borxhit/
22. http://www.instat.gov.al/media/8293/njoftim-per-media-tregu-i-punes-2020.pdf
23. Zeneli, Valbona. “Economic Development in the Western Balkans: On the Road to Competitive Market Economies?” Connections, vol. 13, no. 4, Partnership for Peace Consortium of Defense Academies and Security Studies Institutes, 2014, pp. 53–64, http://www.jstor.org/stable/26326377.
24. Totev, Stoyan, and Luan Shahollari. “Agriculture Development and Trade in Bulgaria, FYR of Macedonia and Albania in the Context of the Common Agriculture Policy.” SEER: Journal for Labour and Social Affairs in Eastern Europe, vol. 4, no. 3, Nomos Verlagsgesellschaft mbH, 2001, pp. 51–69, http://www.jstor.org/stable/43291883.